



Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivery	21.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinita Org. Unit	Hr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHCK	2309	2022	119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.734/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.110/2020 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 09.03.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.734/2019 të datës 25.11.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër vendimit me numër:34620 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës i datës 01.11.2019 çështjen juridike "pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.734/2019 e datës 25.11.2019 parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj, ankuesit sipas ndryshim dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 02.12.2014 i punësuar në Komunën e Kamenicës në pozitën "Përfaqësues Ligjor", Kryetari i Komunës së Kamenicës me datë 26.09.2019 ka nxjerrë vendimin me numër:30336 përmes të cilit ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënie e tij e punës deri në përfundimin e procedurës penale të iniciuar ndaj tij.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin numër:30336 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 18.10.2019. Ndërsa, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë vendimin me numër:34620



të datës 01.11.2019 përmes të cilit e ka shpallur veten jo kompetent për ta trajtuar ankesën e ankuesit të datës 18.10.2019.

Ankuesi, i pakënaqur me vendimin me numër:34620 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 01.11.2019, ka parashtruar ankesë përmes postë me datë 22.11.2019 e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 25.11.2019 dhe është protokolluar me numër protokolli 5514/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.10.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës. Komuna e Kamenicës më datë 13.12.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 09.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.110/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.12.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 25.11.2019.

Ndërsa pas kërkesës së Këshillit të datës 13.04.2022, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës përmes e-mailit të datës 13.04.2022 ka dërguar prova shtesë lidhur me gjendjen faktike dhe rrethanave juridike të krijuara pas dorëheqjes së ankuesit nga pozita e tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5514/2019 të datës 25.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër:34620 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës i datës 01.11.2019; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave e datës 18.10.2019; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Kamenicës i datës 26.09.2019 me numër:30336; Zarfën e postës i datës 22.11.2019 me shifër:R8077689; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 29.11.2019; Flet kthesën e datës 02.12.2019; Përgjigjen në kërkesë e datës 13.12.2019 me numër protokolli:5821/2019; Përgjigjen e datës 13.11.2019 me numër:35810 të Prokurorit të shtetit; Procesverbalin e datës 05.08.2019 me numër:23224 i Komisionit për verifikim dhe kontrollim; Procesverbalin e datës 24.07.2019 me numër:22071 të Komunës së Kamenicës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të ankuesit i datës 01.12.2014; E-mailin e datës 24.07.2019 dërguar nga \_\_\_\_\_ për kryetarin e Komunës së Kamenicës; Vendimin me numër:32440 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Kamenicës i



datës 16.10.2019; Vërejtjen e datës 27.06.2019 me numër:18642; Formularin për raportimin e shkeljes disiplinore i datës 12.06.2018; Shkresën regjistratore të datës 15.07.2019; E-mailin e datës 13.04.2021 dërguar nga këshilli për Njësinë e Burimeve Njerëzore; E-mailin e datës 13.04.2021 dërguar nga Njësinë e Burimeve Njerëzore për Këshillin; Njoftimin e ankuesit të datës 12.03.2020; Vendimin e kryetarit të komunës i datës 26.03.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë është bërë i pamundur apo i kotë andaj edhe mbi këtë bazë ligjore Kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, ka gjetur se ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 12.03.2020 përmes shkresës njoftuese me numër: Sh.02/Nr.7632 e ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Kamenicës se i njëjti jep dorëheqja nga pozita "Përfaqësues Ligjor" i Komunës së Kamenicës, ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës me datë 26.03.2020 ka nxjerrë vendimin me numër: Sh.02/Nr.8095 njëherit e ka liruar ankuesin nga funksioni si dhe e ka shfuqizuar akt e emërimit të tij të datës 02.12.2014 me numër: 02/39301, andaj në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: "**Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë**", Kolegji ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative, respektivisht të drejtës ankimore të ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit e të cilit burojnë sipas aktit të emërimit të datës 02.12.2014 me numër: 02/39301 faktikisht më nuk ekzistojnë apo janë të pamundura pasi që i njëjti është shfuqizuar me vendim të Kryetarit të Komunës pas njoftimit të dorëheqjes së ankuesit sipas shkresës së datës 12.03.2020 dhe mbi këtë bazë Kolegji ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ i nisur sipas ankesës së ankuesit të datës 25.11.2019 i shqyrtuar sipas Aktgjykimit A.nr.110/2020 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 09.03.2022 i pranuar në Këshill me datë 28.03.2022.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshilla juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda, A.nr.734/2019, datë 21/04/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

